

VENDIM
Nr.7, datë 1.4.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Hilmi Dakli,	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese		
Veli Budo,	Anëtar i	"	"
Franc Jakova,	Anëtar i	"	"
Zija Vuci,	Anëtar i	"	"
Alfred Karamuço,	Anëtar i	"	"
Kristofor Peçi,	Anëtar i	"	"
Halil Kopani,	Anëtar i	"	"

me sekretare Drita Filto më datë 12.1.1998, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.62/2 Akti që i përket:

KËRKUES: HASAN LAÇAJ, i përfaqësuar nga avokat Kirov Babliku.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. AGJENCIA KOMBËTARE E PRIVATIZIMIT, NË MUNGESË.

2. SHOQËRIA TREGTARE "ROZAFAT" SHKODËR, E PËRFAQËSUAR NGA z. Adnan Muka.

3. Komuniteti Mysliman Shqiptar, i përfaqësuar nga Avokat dilaver Rexhepi.

OBJEKTI:

Shfuqizimin si antikushtetues të Vendimit nr.83, datë 21.1.1997 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji shpjegimet e përfaqësuesit të palës kërkuese, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Në kuadrin e privatizimit të pronës shtetërore, Agjencia Kombëtare e Privatizimit, duke u mbështetur në Ligjin nr.7512, datë 10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e prinës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit, me shkresën nr.3634, datë 13.11.1995, ka autorizuar kalimin e Hotel Turizmit "Rozafa" Shkodër në pronësi private në favor të 40 ish të përndjekurve politikë, të cilët kanë formuar shoqërinë tregtare "Rozafat" Shkodër dhe, mbi këtë bazë, më datë 28.06.1996 Filiali i Albturizmit Hotel "Rozafa" Shkodër ka bërë shitjen e këtij hoteli këtyre ish të përndjekurve politikë.

Kërkuesi, duke qenë ish-pronar i një pjese të truallit nën objekt, ka kërkuar në gjykatë deklarimin e pavlefshëm të veprimit juridik të kësaj kontrate shitjeje me pretendimin se si ish-pronar trualli, në bazë të nenit 21 të Ligjit nr.7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", gëzon të drejtën e parablerjes të këtij objekti.

Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.2869, datë 12.04.1996, ka vendosur rrëzimin e padisë për mungesë objekti, vendim të cilin Gjykata e Apelit me vendimin e saj nr.3942, datë 10.07.1996 e ka prishur dhe, duke e gjykuar çështjen në fakt, ka vendosur pranimin e padisë, deklarimin të pavlefshëm të veprimit juridik dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme.

Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit, me vendimin nr.83, datë 21.01.1997, ka vendosur prishjen e këtij vendimi dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit me plotësimin se padia rrëzohet për mungesë të legjitimitetit aktiv të palës paditëse.

Në vendimin e kolegjit civil, arsyetohet se kërkuesi nuk legjitimohet në ngritjen e padisë, pasi në pronësi ka 30.7 % të sipërfaqes së truallit nën objektin e Hotelit "Rozafa", sepse sipas pikës 8, paragrafi 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.203, datë 03.05.1995, ish-pronari duhet të ketë në pronësi mbi 80 % të sipërfaqes së truallit nën objekt për të gëzuar të drejtën e parablerjes së të gjithë

objektit dhe se akti i shitblerjes së hotelit nga 40 ish të përndjekurit është i ligjshëm, pasi e drejta e parablerjes atyre u lind në bazë të nenit 12 të Ligjit nr.7748, datë 29.07.1993 “Për statusin e ish të përndjekurve e persekutuarve politikë”.

Një zgjidhje e tillë e çështjes nga Gjykata e Kasacionit është e gabuar, sepse në radhë të parë vjen në kundërshtim me pikën 8, paragrafi 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, i cili nuk i mohon ish-pronarit të drejtën e parablerjes qoftë edhe në pjesë të objektit kur i nënshtrohet privatizimit, si dhe me nenet 27 dhe 38 të Kreut “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”, të Ligjit nr.7692, datë 31.03.1993 “Për një shtojcë në Ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, sepse sipas këtyre dispozitave fitimi i pronësisë rregullohet me ligj dhe se prona ose të drejtat e pranuar me ligj nuk mund të cënohen pa një proces të rregullt ligjor.

Në rastin konkret e drejta e kërkuarit për të fituar pronësinë e objektit mbi truallin ish-pronë e tij është sanksionuar në nenin 21 të Ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, sipas të cilit: “Në trojet e zëna me ndërtime shtetërore, si dyqane, magazina, punishte etj., ish-pronarët kanë të drejtën e parablerjes së këtyre objekteve, kur privatizohen me çmimet e përcaktuara sipas dispozitave në fuqi”.

Sipas kësaj dispozite, e drejta e parablerjes është një e drejtë parimore e ish-pronarëve të truallit mbi të cilin ndodhet objekti që i nënshtrohet privatizimit dhe, si mënyrë fitimi e pronës së rregulluar me ligj, përbën një të drejtë kushtetuese të pacënueshme, e cila nuk mund të mohohet jashtë vullnetit të ish-pronarit, pavarësisht nga pjesa që i takon në privatizim.

Gjithashtu, Gjykata e Kasacionit ka pranuar se akti i shitjes së Hotelit “Rozafa”, 40 ish të përndjekurve politikë është i ligjshëm nga që e drejta e parablerjes atyre u lind në bazë të nenit 12 të Ligjit nr.7748, datë 29.07.1993 “Për statusin e ish të përndjekurve dhe të persekutuarve politikë nga sistemi komunist”.

Ky konkluzion i Gjykatës nuk është i drejtë mbasi vjen në kundërshtim me Vendimin nr.10, datë 31.07.1995 të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit ligji i sipërm “I njeh të drejtën Këshillit të Ministrave të marrë masa favorizimi ndaj të përndjekurve politikë, por jo t’u njohë të drejtën e parablerjes së objekteve të ndërtuara mbi truallin e ish-pronarëve”.

Gjykata e Kasacionit po kështu, ndërsa e ka gjykuar çështjen në themel, duke arsyetuar se veprimi juridik (kontrata e shitjes) është i ligjshëm, vendos rrëzimin e padisë për shkak se mungon legjitimimi aktiv i palës paditëse. Ky qëndrim i Gjykatës vjen në kundërshtim me nenin 86 të Kodit të Procedurës Civile (të vjetër), sipas të cilit nga kushdo mund të ngrihet padi “për të kërkuar rivendosjen e një të drejte të mohuar”.

Në rastin në shqyrtim, kërkuari si palë e interesuar, legjitimohet për të kërkuar me anën e Gjykatës, njohjen e të drejtës së mohuar ose të shkelur nga një veprim juridik i kryer nga një i tretë, i cili, sipas tij i ka cënuar interesin pasuror të tij, që është e drejta e parablerjes së objektit që i nënshtrohet privatizimit, të ndërtuar në truallin e tij. Ligjërisht çdo person justifikohet në kërkimin për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar nga një i tretë (legjitimimi aktiv) dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprimin e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuarit (legjitimimi pasiv).

Gjykata duke rrëzuar padinë për mungesë legjitimimi aktiv i ka mohuar kërkuarit të drejtën të mbrojtë interesat e tij, të cilat pretendon se nga një veprim juridik i paligjshëm i janë cënuar. Kjo vetëvetiu përbën një shkelje të rëndë procedurale civile, e cila e bën procesin gjyqësor të parregullt, që passjell cënimin e të drejtës së kërkuarit të pranuar me ligj për parablerjen e objektit të ndërtuar mbi pronën e tij.

Në këto kushte, Vendimi nr.83, datë 21.01.1997 i kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit është antikushtetues, sepse nga sa u parashtrua janë shkelur nenet 27 dhe 38 të Ligjit Kushtetues nr.7692, datë 31.03.1993 për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”, konkretisht e drejta e fitimit të pronës të rregulluar me ligj dhe e drejta për një proces të rregullt ligjor.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 24 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", njëzëri

VENDOSI:

Të shfuqizojë si antikushtetues vendimin nr.83, datë 21.1.1997 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit, duke e kthyer çështjen për rishqyrtim në atë Gjykatë.

Ky vendim është përfundimtar, i formë së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.